

TËRHEQJA E LEJES SË DREJTIMIT

Leja e drejtimit tërhiqet menjëherë gjatë qarkullimit kur drejtuesi i mjetit:

-Drejton me leje drejtimi që i ka kaluar afati;

-Kur nuk i është nënshtruar kontrollit të rishikimit në kufijtë e parashikuar apo ka rezultuar përkoheisht jo i përshtatshem për drejtimin e mjetit për mosplotësim të kushteve mjekësore;

-Kur nuk ka sistemuar ngarkesën në mënyrë të rregullt.

Në këto raste leja e drejtimit i kthehet të interesuarit vetëm pas përmbushjes së detyrimeve.

Leja e drejtimit mund të tërhiqet në rast të shkeljeve për të cilat është parashikuar pezullimi në kohë të përcaktuar, p.sh. në rast të drejtimit të mjetit në gjendje të dehur.